

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT –i:

Adresa e Selise:

Data e krijimit:

Nr. I Regjistrit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

“VIANTE Konstruksion” sh.p.k

K47103804L

Gramsh

23.02.2005

33037

Ndertim – Projektim, Rikonstruksione

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2014

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2014-31.12.2014

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 28.02.2015

1. Bilanci Kontabel i dates 31.12.2014

		Ne lek		
AKTIVET		Shenime	Viti 2014	Viti 2013
I	Aktivitet afatshkurtra			
1	Aktive monetare	1	1,086,093	3,451,961
2	Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i)	Llogari/Kerkesa te arketueshme	2	29,651,436	30,543,744
(ii)	Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	3	732,599	171,452
(iii)	Instrumenta te tjera borxhi	4	10,118,000	5,600,000
	Totali 2		<u>40,502,035</u>	<u>36,315,196</u>
	Totali i Aktiveve Afatshkurtra (I)		<u>41,588,128</u>	<u>39,767,157</u>
II	Aktivitet afatgjata			
1	Aktive afatgjata materiale			
(i)	Makineri dhe pajisje	5	8,591,786	7,186,636
	Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		<u>8,591,786</u>	<u>7,186,636</u>
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		<u>50,179,914</u>	<u>46,953,794</u>

Administratori

Hartuesi i pasqyrave

Gjergji Bezati



Anita Pulaj

Bilanci Kontabel i dates 31.12.2014

DETYRIMET DHE KAPITALI		Shenime	Viti 2014	Ne lek Viti 2013
I	Detyrimet afatshkurta			
1	Huat dhe parapagimet			
(i)	<i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>	6	7,249,704	16,699,971
(ii)	<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>	7	5,826,000	244,193
(iii)	<i>Detyrime tatimore</i>	8	133,063	318,665
(iv)	<i>Divident per tu paguar</i>	9	25,200,000	500,000
(v)	<i>Detyrime te tjera</i>	10	6,000,000	-
	Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		<u>44,408,767</u>	<u>17,762,828</u>
II	Detyrime afatgjata			
	Totali i detyrimeve afatgjata (II)		<u>-</u>	<u>-</u>
	Totali i detyrimeve (I+II)		<u>44,408,767</u>	<u>17,762,828</u>
III	KAPITALI			
1	Kapitali aksionar	11	1,100,000	16,900,000
2	Rezerva ligjore	11	90,965	1,052,932
3	Rezerva te tjera	11	-	4,000,000
4	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	11	4,580,182	7,238,033
	Totali i Kapitalit (II)		<u>5,771,147</u>	<u>29,190,965</u>
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I, II, III)		<u>50,179,914</u>	<u>46,953,794</u>

Administratori

Hartuesi i pasqyrave

Gjergji Bezati



Anita Pulaj

2. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen 01 Janar - 31 Dhjetor 2014

Nr	Pershkrimi i elementeve		Ne lek	
			Viti 2014	Viti 2013
1	Shitjet neto	12	<u>56,558,911</u>	<u>68,259,533</u>
2	Materialët e konsumuara	13	(37,576,386)	(52,095,789)
3	Kosto e punes	14	(5,821,083)	(4,121,025)
	- pagat e personelit	14	(4,988,075)	(3,531,296)
	- shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	14	(833,008)	(589,729)
4	Amortizimi dhe zhvleresimet	15	(1,446,673)	(1,631,028)
5	Shpenzime te tjera	16	(7,569,593)	(1,099,768)
6	Totali i shpenzimeve (shuma 2-6)		<u>(52,413,735)</u>	<u>(58,947,610)</u>
7	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+/-2-6)		<u>4,145,176</u>	<u>9,311,923</u>
8	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare		-	-
	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime te tjera			
9	financiare afatgjata		-	-
10	Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		-	13,967
11	Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit	17	1,243,510	(1,257,796)
12	Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	18	(201)	(23,252)
13	Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare (8+/-9+/-10+/-11+/-12)		<u>1,243,309</u>	<u>(1,267,081)</u>
14	Fitimi (humbja) para tatimit (7+/-13)	19	<u>5,388,485</u>	<u>8,044,842</u>
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	19	(808,303)	(806,809)
16	Fitimi/humbja neto e vitit financiar (14-15)	19	<u>4,580,182</u>	<u>7,238,033</u>

Administratori

Gjergji Bezati



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

3. Pasqyra e levizjeve ne kapitalet e veta per periudhen 01 Janar - 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva statutore dhe ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	Totali
Pozicioni me 31 dhjetor 2012	<u>16,900,000</u>	<u>808,136</u>	<u>-</u>	<u>4,774,796</u>	<u>22,482,932</u>
Fitimi neto per periudhen kontabel				7,238,033	7,238,033
Rritja e rezerves se kapitalit		244,796	4,000,000	(4,244,796)	-
Dividentet e paguar				(530,000)	(530,000)
Pozicioni me 31 dhjetor 2013	<u>16,900,000</u>	<u>1,052,932</u>	<u>4,000,000</u>	<u>7,238,033</u>	<u>29,190,965</u>
Fitimi neto per periudhen kontabel				4,580,182	4,580,182
Dividentet e paguar	(28,000,000)	(1,400,000)	(4,000,000)	(7,238,033)	(40,638,033)
Rritja e rezerves se kapitalit	12,200,000	438,033			12,638,033
Pozicioni me 31 dhjetor 2014	<u>1,100,000</u>	<u>90,965</u>	<u>-</u>	<u>4,580,182</u>	<u>5,771,147</u>

Administratori

Gjergji Bezati



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

4. Pasqyra e flukseve te parase per periudhen 01 Janar - 31 Dhjetor 2014

	<i>Metoda indirekte</i>	
	Viti 2014	Viti 2013
Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	5,388,485	8,044,842
Rregullime per:		
Amortizimin	1,446,673	1,631,028
Te ardhura nga investimet		
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	(3,784,925)	(20,898,401)
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar nga aktiviteti	26,645,939	13,198,411
Tatim fitimi i paguar	(1,210,217)	(857,136)
<i>Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit</i>	<u>28,485,954</u>	<u>1,118,745</u>
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(2,851,823)	(3,925,538)
<i>Paraja neto e perdorur ne aktivitetet investuese</i>	<u>(2,851,823)</u>	<u>(3,925,538)</u>
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare		
Dividentet e paguar	(28,000,000)	(530,000)
<i>Paraja neto e perdorur ne aktivitetet financiare</i>	(28,000,000)	(530,000)
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	<u>(2,365,868)</u>	<u>(3,336,794)</u>
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	<u>3,451,961</u>	<u>6,788,755</u>
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	<u>1,086,093</u>	<u>3,451,961</u>

Administratori

Hartuesi i pasqyrave

Gjergji Bezati



Anita Pulaj

SHENIMET SHPJEGUESE

Shoqeria « VIANTE Konstruksion» shpk eshte krijuar ne date 23.02.2005 me Vendimin Nr. 33037 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me ortak dhe administrator te vetem Z.Gjergji Bezati. Kapitali i shoqerise eshte 1,100,000 leke dhe kuotat e tij zoterohen 100% nga ortaku I vetem.

Politikat kontabel

Politikat kryesore kontabel te adoptuara per pregatitjen e ketyre pasqyrave financiare paraqiten si me poshte. Keto politika jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjithë vitet e paraqitura, pervec kur percaktohet ndryshe.

1.1 Bazat e pregatitjes

Pasqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te perfshira ne ligjin Nr 9228 date 29 Prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin Nr 9477 date 09.02.2006 dhe me urdhrin e Ministrit te Financave Nr 65 date 5.05.2008.

Keto pasqyra financiare jane pregatitur bazuar ne parimin e koston historike parimin e biznesit ne vijimesi dhe parimit te drejtave te konstatuara.

Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane te shprehura ne Leke, qe eshte monedha raportuese e shoqerise. Disa riklasifikime jane bere te nevojshme per vlerat krahasuese per te qene konform prezantimit te vitit aktual.

a) Monedhat e huaja*Monedha funksionale dhe e prezantimit*

Zerat e perfshire ne pasqyrat financiare te Shoqerise maten duke perdorur monedhen e mjedisit kryesor ekonomik ne te cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke, e cila eshte monedha e prezantimit te Shoqerise.

Transaksionet dhe gjendjet

Ne pregatitjen e pasqyrave financiare te Shoqerise, transaksionet ne monedha te ndryshme krahasuar me monedhen funksionale te Shoqerise (monedhat e huaja) rregjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne cdo date te Bilancit Kontabel, aktivet dhe detyrimet monetare qe jane ne monedha te huaj perkthehen me kursin zyrtar te kembimit te dates se Bilancit Kontabel. Diferencat nga kembimi njihen ne fitim ose humbje ne periudhen ne te cilen lindin. Aktivet dhe detyrimet jomonetare qe jane njohur me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet ne monedha te huaja dhe qe jane paraqitur me vlere te drejte perkthehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten qe eshte percaktuar vlere e drejte.

Monedhat e huaja me te cilat operon Shoqeria jane Euro dhe USD (dollari amerikan). Kursi i kembimit zyrtar i Bankes se Shqiperise (Leku kundrejt njesise se monedhave te huaja) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 eshte si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2014
Dollari amerikan (USD)	115.23	101.86
Euro (Euro)	140.14	140.2

b) Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri ne te ardhmen, dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme. Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e

perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose zbritjet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe kur realizohen të ardhurat për të cilat janë kryer keto shpenzime.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ato ndodhin sipas parimit të drejtave të konstatuara dhe kontabilitetit rrjedhës.

c) **Tatimet**

Tatimi mbi fitimin

Aktivi dhe detyrimet për tatimin mbi fitimin për periudhën aktuale maten me shumën e pritura për të marrë nga apo për të paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet për tatimet të përdorura për llogaritjen e vlerës së tatimit fitimit, janë ato të nxjerra ose të publikuara në datën e raportimit në Shqipëri, ku Shoqëria operon dhe siguron të ardhura të tatueshme.

Tatim mbi fitimin aktual që lidhet me zera të njohur direkt në kapital njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e të ardhurave. Drejtimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionet e ndërmarrja në formularet e deklarimit të pagesave në lidhje me situatën në të cilat rregulloret e aplikueshme për tatimet janë subjekt i interpretimeve, si dhe një provizion nëse është e përshtatshme.

Tatim fitimi llogaritet me 15% (31.12.14: 15%) mbi fitimin e tatueshem.

Tatimi fitimi i shtyre

Shoqëria nuk ka zgjedhur të zbatojë standartin SKK 11 për sa i përket njohjes së Tatimit fitimit të shtyre.

d) **Aktive afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe/ose nëse ka humbje të rënies së vlerës. Në tilla kosto përfshihen kostot e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale dhe kostot e huase për projektet afatgjata nëse plotësohen kriteret e njohjes. Kur pjesë të rëndësishme të aktiveve afatgjata materiale nevojiten të zëvendësohen në intervale, Shoqëria i njeh këto pjesë si aktive të vecanta me vlerë të dobishme specifike dhe i zhvlerëson ato në përputhje me rrethanat. Në të njëjtën mënyrë, kur kryhet një inspektim i madh, kosto e tij njihet në vlerën e mbartur të aktivitet afatgjatë material si një zëvendësim nëse plotësohet kriteri i njohjes. Të gjitha riparimet e tjera dhe kostot e mirëmbajtjes njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.

Vlera kontabel e aktiveve afatgjata materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëq.s rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabel tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivitet ose njesite gjeneruese të parase do të pakesohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi llogaritet me metodën e vlerës së mbetur të aktiveve si më poshtë:

Ndertesat	5%
Mietet transporti	20%
Makinëri dhe pajisje	20%

Një zë i aktiveve afatgjata materiale si dhe ndonjë pjesë e rëndësishme e njohur fillimisht, rregjistrohet me daljen jashtë përdorimi të saj ose kur nuk pritet të sigurohen përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja jashtë përdorimit. Cdo fitim apo humbje që realizohet nga dalja jashtë përdorimit

e aktivitet (llogaritur si ndryshimi ndermjet te hyrave neto nga dalja jashte perdorimit dhe vlera e mbartur e aktivitet) perfshihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi crregjistrohet. Vlerat e rikuperueshme e aktivitet, jeta e dobishme dhe metodat e zhvleresimit rishikohen cdo fund viti financiar dhe rregullohen nese eshte e domosdoshme ne menyre prospektive.

e) **Aktivet dhe detyrimet financiare**

i) *Aktivet financiare*

Aktivet financiare konsistojne teresisht ne llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme dhe jane pasqyruar ne Bilancin Kontabel bazuar ne shumate e faturuara. Kerkesat per t'u arketuuar, te ardhurat e konstatuara dhe llogari te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u arketuuar ne para regjistrohen ne Bilancin Kontabel me kosto te amortizuar. Kostoja e amortizuar e kerkesave per t'u arketuuar afatshkurtra, ne pergjithesi eshte e barabarte me vleren e tyre nominale (minus provizionet e krijuara per renie ne vleren), keshtu qe kerkesat afatshkurtra regjistrohen e vleren e tyre neto te realizueshme (e cila raportohet, per shembull ne nje fature, kontrate ose dokument tjetër). Provizione per llogarite e arketueshme nuk jane llogaritur pasi eshte gjykuar qe ekziston nje siguri qe te drejtat nga klientet do te arketohen.

Crregjistrimi

Nje aktiv financiar (ose ku eshte e mundur pjese e aktivitet financiar apo grup aktivesh financiare te ngjashme) crregjistrohet kur:

- ✓ Te drejtat per te siguruar flukse monetare nga aktivi kane perfunduar
- ✓ Shoqeria ka transferuar te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga aktivi ose ka supozuar nje detyrim per te paguar flukset monetare te mara ne teresi, pa vonesa materiale nje pale te trete nepermjet nje marreveshjeje; dhe ose
 - (a) Shoqeria ka transferuar ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet ose
 - (b) Shoqeria as nuk ka transferuar dhe as ka mbajtiur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, por ka transferuar kontrollin e aktivitet.

Kur Shoqeria ka transferur ne menyre thelbesore te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga nje aktiv ose ka hyre ne nje marreveshje; ajo vlereson nese dhe ne cfare mase ka mbajtur rreziqet dhe perfitimet e pronesise. Kur as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, nuk ka transferuar as kontrollin e aktivitet, aktivi do njihet ne masen e perfshirjes se vazhdueshme te Shoqerise ne aktiv. Ne kete rast, Shoqeria njeh gjithashtu nje detyrim te lidhur. Aktivi i transferuar dhe detyrimi i lidhur maten ne bazen qe reflekton te drejtat dhe detyrimet qe Shoqeria ka marre persiper. Perfshirja e vazhdueshme qe merr formen e garancise mbi aktivin e transferuar matet me me te voglen ndermjet vleres origjinale te mbartur te aktivitet dhe vleres maksimale te konsiderates qe Shoqeria mund te jete e detyruar te ripaguaje.

ii) *Renia ne vlere e aktiveve financiare*

Shoqeria vlereson ne cdo date te raportimit, nese ka evidence objektive qe nje aktiv financiar apo grup aktivesh ka pesuar renie vlere. Nje aktiv financiar apo nje grup aktivesh financiare konsiderohet i zhvleresuar vetem nese ka evidence objektive per zhvleresimin si rezultat i nje ose me shume ngjarjeve qe kane ndodhur pas njohjes fillestare te nje aktivitet (nje "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare te ardhshme te vleresuara te aktivitet financiar apo grupit te aktiveve financiare dhe qe mund te matet ne menyre te besueshme. Evidence e zhvleresimit mund te perfshije tregues qe debitoret apo grup debitorësh mund te jene duke perjetuar probleme te medha financiare, mospagesa ne kohe te principalit apo interesit, probabiliteti qe ata te kalojne ne falimentim ose nje riorganizim tjeter financiar dhe kur te dhenat e veshgueshme tregojne se ka nje renie te matshme

te flukseve monetare te ardhshme te parashikuara, te tilla si ndryshime ne fusha dhe kushtet ekonomike qe jane ne korrelacion me vonesat.

iii) Detyrimet financiare

Detyrimet financiare konsistojne teresisht ne llogari te pagueshme dhe te tjera te pagueshme jane pasqyruar ne Bilancin Kontabel bazuar ne shumet e faturuara. Detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra, jane llogaritur me kosto, dhe jane detajuar me poshte. Gjithashtu ne detyrimet afatgjata jane paraqitur dhe disa kontribute te ortakeve te cilat jane bere per te financuar zhvillimin e aktivitetit.

f) Inventaret

Inventaret jane paraqitur me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto perbehet nga materialet direkte dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme, koston e punes direkte dhe ato kosto te pergjithshme qe kane ndodhur per te sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet aktuale te magazinimit. Kosto eshte llogaritur duke perdorur metoden FiFo per lenden e pare. Vlera neto e realizueshme perfaqeson cmimin e vleresuar te shitjes minus koston e vleresuar te perfundimit dhe koston e marketingut, shitjes dhe shperndarjes. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me vleren neto te realizueshme.

g) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne Bilancin Kontabel perfshijne mjetet monetare ne banke ne dhe ne arke ne Leke dhe ne monedha te huaja dhe depozitat ne te pare me nje maturitet deri ne 3 muaj. Per qellime te pasqyres se flukseve te mjeteve monetare Mjetet monetare perfshijne sa me siper.

h) Detyrimet per sigurimet shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

i) Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbartin perfitime ekonomike. Nje aktiv i kushtezuar nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlera e nje humbje te kushtezuar njihet si provizion nese ka mundesi qe ngjarje te ardhshme do te konfirmohen, nje detyrim do te haset ne daten e Bilancit Kontabel dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes.

j) Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter. Per qellim te shpalosjes ne pasqyrat financiare, vetem ortaku i Shoqerise do te konsiderohet pale e lidhur.

k) Ngjarje pas dates se bilancit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese per pozicionin e Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.

II. Shenimet qe shpjegojne zerat e ndryshem te pasqyrave financiare.

Bilanci Kontabel, Aktivet

1. Aktivet monetare

Aktivt monetare jane ne shumen 1,086,093 leke te pasqyruara ne tabelen e meposhtme:

Nr	Likujditete	Viti 2014	Viti 2013
1	Depozita ne banke	1,020,203	319,009
2	Para ne arke	65,891	3,132,952
	Totali	<u>1,086,093</u>	<u>3,451,961</u>

Depozitat ne banke ne monedhe te huaj jane te konvertura me kursin Bankese se Shqiperise me 31.12.2014, diferencat nga kursi i kembimit jane te pasqyrura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

2. Kerkesa te arketueshme

Shuma prej 29,651,436 leke perfaqeson fatura te palikujduara nga klientet deri me 31.12.2014.

Nr	Kerkesa per arketim	Viti 2014	Viti 2013
1	Klient per shitje e sherbime	29,651,436	30,543,744
	Totali	<u>29,651,436</u>	<u>30,543,744</u>

3. Kerkesa te tjera te arketueshme

Shuma prej 732,599 leke paraqitet ne postin kerkesa te tjera te arketueshme me 31.12.2014, e detajuar si me poshte :

Nr	Kerkesa te tjera per arketim	Viti 2014	Viti 2013
1	Tatim fitimi I mbipaguar	573,366	171,452
2	Tvsh	159,233	-
	Totali	<u>732,599</u>	<u>171,452</u>

4. Instrumenta te tjera borxhi

Paraqitet shuma prej 10,118,000 leke, e cila perfaqeson huane dhene shoqerise «Isobar Construction» shpk.

5. Aktive afat gjata materiale

Jane te paraqitura ne vleren neto te ryre me 31.12.2014 per 8,591,786 leke, sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Emertimi	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
I	Aktive afat gjata materiale			
1	Gjendja me 31.12.2013	11,191,537	910,286	12,101,823
2	Shtesat per 2014	2,851,823	-	2,851,823
3	Paksimet per 2014	-	-	-
4	Gjendja me 31.12.2014	<u>14,043,360</u>	<u>910,286</u>	<u>14,953,646</u>
II	Amortizimi I AQT-ve			
1	Gjendja me 31.12.2013	4,276,464	638,723	4,915,186
2	Shtesat per 2014	1,383,704	62,969	1,446,673
3	Paksimet per 2014	-	-	-
4	Gjendja me 31.12.2014	<u>5,660,168</u>	<u>701,692</u>	<u>6,361,859</u>
III	Vlera neto 31.12.2014	<u>8,383,193</u>	<u>208,595</u>	<u>8,591,786</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013.

Bilanci Kontabel, Pasivet

6. Te pagueshme ndaj furnitoreve

Gjendja e tyre ne 31.12.2014 eshte 7,249,704 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2014 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

7. Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqitet detyrimi ndaj punonjesve i palikujduar deri me 31.12.2014 ne shumen 5,826,000 leke.

8. Detyrimet tatimore

Jane te paraqitura detyrimene shumen 133,063 leke, me 31.12.2014 sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2014	Viti 2013
1	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	126,563	79,236
2	Tatimi mbi te ardhurat personale	6,500	8,000
3	Tatim mbi vleren e shtuar	-	165,390
4	Tvsh sipas akt-kontrollit	-	42,787
5	Detyrime sipas akt-kontrollit	-	23,252
	Totali I detyrimeve	<u>133,063</u>	<u>318,665</u>

9. Divident per tu paguar

Paraqitet shuma e detyrimit per divident te shperndare nga shoqeria po te palikujduar deri me 31.12.2014 ne vleren 25,200,000 leke. **Theksojme se shoqeria e ka paguar detyrimin per tatimin mbi dividendin sipas afateve ligjore.**

10. Detyrime te tjera

Paraqitet detyrimi i shoqerise per hua te marre nepermjet bankes ne shumen 6,000,000 leke me 31.12.2014.

11. Kapitali

Kapitali paraqitet si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva ligjore	Divident	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2013	16,900,000	1,052,932	-	4,000,000	7,238,033	29,190,965
2	Shtesat per 2014	-	-	28,000,000	-	4,580,182	32,580,182
3	Pakesimet per 2014	(15,800,000)	(961,967)	(28,000,000)	(4,000,000)	(7,238,033)	(56,000,000)
	Gjendja me 31.12.2014	<u>1,100,000</u>	<u>90,965</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>4,580,182</u>	<u>5,771,147</u>

Gjate vitit 2014 shoqeria ka zvogeluar kapitalin e regjistruar per shumen 15,800,000 leke. Procedura e zvogelimit te kapitali eshte regjistruar prane Regjistrat Tregtar. Shoqeria ka shpendare divident ne

shumen 28,000,000 leke. Kapitalet e veta jane shtuar me fitimin e vitit ne shumen 4,580,182 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise eshte 5,771,147 leke.

PASH-Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

12. Te ardhura

Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqerise per vitin 2014 jane 56,558,911 leke.

Sqarim:

Ju sqarojme se shuma e te ardhurave prej 9,952,601 leke, e raportuar ne rubriken e eksporteve perfaqeson vleren e sherbimeve qe shoqeria ka kryer per punimet ne Hidrocentralin e Banjes, per shoqerine “Limak” shoqeri nenkontraktore e “Devoll Hydropower”, e cila ka te drejte te emeruje nenkontraktore te nivelit te 2-te (Viante Konstruksion), nga ku lind e drejta per te pergatitur fatura te cilat do te jene me TVSH 0% dhe do te pasqyrohen ne rubriken “eksporte” me shenimin perkates “Sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit Nr. 105/2014 date 28.03.2014”.

13. Materialet e konsumuara

Materialet e konsumuara paraqiten ne shumen 37,576,386 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2014	Viti 2013
1	Materiale te para	32,645,882	46,094,019
2	Karburant	4,930,505	5,808,800
3	Transport	-	192,970
	Shuma	<u>37,576,386</u>	<u>52,095,789</u>

14. Shpenzime personeli

Shpenzimet per personelin ne shumen 5,821,083 leke jane te detajuara si me poshte :

Nr	Kosto e Punes	Viti 2014	Viti 2013
1	Shpenzime per paga	4,988,075	3,531,296
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	833,008	589,729
	Shuma	<u>5,821,083</u>	<u>4,121,025</u>

Permbledhesja e pagave per vitin 2014 eshte paraqitur me poshte:

Nr	Muaji	Nr punonj	Paga Gjithsej	Paga mbi te cilen llog kontributet	Kontribut Punedhenesi 16.7%	Kontribut Punemarresi 11.2%	Tatimi ne leke	Paga neto
1	Janar	10	284,000	284,000	47,428	31,808	6,500	245,692
2	Shkurt	10	284,000	284,000	47,428	31,808	6,500	245,692
3	Mars	11	285,380	285,380	47,659	31,963	6,500	246,917
4	Prill	19	356,672	356,672	59,565	39,947	6,500	310,225
5	Maj	27	542,912	542,912	90,666	60,806	6,500	475,606
6	Qershor	19	490,000	490,000	81,830	54,880	6,500	428,620
7	Korrik	19	490,000	490,000	81,830	54,880	6,500	428,620
8	Gusht	19	477,144	477,144	79,683	53,440	6,500	417,204
9	Shtator	18	443,304	443,304	74,032	49,650	6,500	387,154
10	Tetor	18	446,000	446,000	74,482	49,952	6,500	389,548
11	Nentor	18	435,026	435,026	72,649	48,723	6,500	379,803
12	Dhjetor	22	453,637	453,637	75,756	50,807	6,500	396,330
	Shuma		<u>4,988,075</u>	<u>4,988,075</u>	<u>833,008</u>	<u>558,664</u>	<u>78,000</u>	<u>4,351,411</u>

15. Shpenzime amortizimi

Paraqitet shpenzimi per amortizimin e asetëve te shoqerise per vitin 2014 ne shumen 1,446,673 leke.

16. Shpenzime te tjera

Ne kete ze jane te perfshira shpenzime ne shumen 7,569,593 leke te detajuara ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2014	Viti 2013
1	Sigurime mjetesh	-	23,600
2	Sherbime bankare	54,444	68,357
3	Shpenzime telefonike	400,468	358,971
4	Sherbim kontabiliteti	390,000	300,000
5	Takse automjeti	-	10,000
6	Taksa Lokale	82,120	82,120
7	Dieta per personelin	6,642,000	256,720
8	Tarife licensimi	560	-
	Shuma	<u>7,569,593</u>	<u>1,099,768</u>

17. Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit

Paraqiten te ardhura per fitimet nga kurset e kembimit ne shumen 1,243,510 leke.

18. Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare

Paraqiten shpenzime ne shumen 201 leke per gjoba e penalitete te shoqerise.

SQARIM

Tabela e meposhtme sqaron shpenzimet me fatura te raportuara ne bilanc me blerjet e raportuara ne sistemin tatimor.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje nga furnitore vendas	39,900,917
2	Blerje te perjashtuara	967,772
	Totali I blerjeve	<u>40,868,689</u>
Nr	Sipas bilancit	
1	Blerje materialesh	37,576,386
2	<i>korigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	-
3	Shpenzime te tjera	7,569,593
4	Blerje AQT	2,851,823
	Shuma	<u>47,997,802</u>
	Diferenca	7,129,113
1	<i>Taksa lokale</i>	(82,120)
2	<i>Sherbime bankare</i>	(54,433)
3	<i>Blerje AQT me kontrate</i>	(350,000)
4	<i>Dieta per personelin</i>	(6,642,000)
5	<i>Tarife licensimi</i>	(560)
	Diference FDP-Bilanc	<u>(0)</u>

19. Llogaritja e rezultatit tatimor

Nr	EMERTIMI	VITI 2014	VITI 2013
1	Te ardhura	56,558,911	68,259,533
2	Shpenzime	(51,170,426)	(60,214,691)
3	Rezultati I ushtrimit	<u>5,388,485</u>	<u>8,044,842</u>
4	Shpenzime te pazbritshme	201	23,252
5	Fitimi I tatueshem	<u>5,388,686</u>	<u>8,068,094</u>
6	Tatimi I fitimit	808,303	806,809
7	Fitimi neto I periudhes	<u>4,580,182</u>	<u>7,238,033</u>

Shoqeria per vitin ushtrimor 2014 paraqitet me nje fitim neto prej 4,580,182 leke. Shpenzimet e pazbritshme jane ne shumen 201 leke, jane shpenzime per gjoba e penalitete.

III-Shenime te tjera shpjeguese

Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime nuk ka .

Gabime materiale te ndodhura ne periudhat kontabel te meparshme te konstatuara gjate periudhes raportuese nuk ka.

Administratori

Gjergji Bezati



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

MARGARITA KALEMASI
TIRANE

RAPORT

PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

VITI 2014

“VIANTE Konstruksion” Shpk

GRAMSH

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Z. Gjergji Bezati, ortakut te vetem te

Shoqerise "VIANTE Konstruksion" sh.p.k

Gramsh

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise **"VIANTE Konstruksion" shpk**, te cilat perbehen nga Bilanci Kontabel i dates 31.12.2014, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyren e flukseve te parave dhe Pasqyra e levizjeve te kapitaleve te veta per ushtrimin e mbyllur ne ate date, si dhe nje permbledhje e metodave te rendesishme kontabel dhe shenimeve te tjera anekse.

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Auditimi yne u krye ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat e etikës dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te marrim nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale

Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire ketu vleresimin e rrezeqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare, si pasoje e mashtrimit apo e gabimit. Kur vlereson keto rrezeqe, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem te entitetit mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare ne menyre qe te planifikoje procedura te pershtatshme auditimi ne rrethanat perkatese te entitetit, por jo per qellim qe te shprehe nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat per opinionin tone te auditimit:

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete e te sinqerte per gjendjen financiare te shoqerise "VIANTE Konstruksion" shpk ne date 31 dhjetor 2014 dhe te rezultatit te saj financiar per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standartet Kombetare te kontabilitetit.

Tirane me 17.03.2015

**Rruga "Reshit Petrela"
pallati ½,kati i 5-te Ap.29
prane Arshives se shtetit
TIRANE**

**Eksperte kontabel e regjistruar
MARGARITA KALEMASI**

